

**MBI**  
**AUDITIMIN E USHTRUAR NË**  
**KËSHILLIN E QARKUT ELBASAN**

Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer në **Këshillin e Qarkut Elbasan**, me objekt: “*Mbi auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë*”, lloji i auditimit: “*Për auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare*”, për periudhën e veprimtarisë 01.01.2012 deri 31.12.2013 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 95, datë 31.7.2014.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “*Për Kontrollin e Lartë të Shtetit*”, me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 8599, date 01.6.2000, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 459/8, datë 31.7.2014, i ka rekomanduar z. Egen Isaj, Kryetar i Këshillit të Qarkut Elbasan Paskuqan, zbatimin e masave të mëposhtme:

**A. MASA ORGANIZATIVE**

1. Këshilli i Qarkut Elbasan, Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Zyrën për Menaxhimin dhe Mbrojtjen e Tokës të merren masat dhe të veprohet për sistemimin në pasqyrat financiare të llogarisë 210 “*Toka troje terrene*”.

***Menjëherë***

2. Këshilli i Qarkut Elbasan, Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Zyrën për Menaxhimin dhe Mbrojtjen e Tokës, lidhur me objektet të cilat duhet të pasqyrohen në llogarinë 213 “*Rrugë, rrjete, vepra ujore*”, të paraqiten me të gjitha të dhënat e duhura si në regjistra ashtu edhe në inventarin e pasurive të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara.

***Menjëherë***

3. Këshilli i Qarkut Elbasan, Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Zyrën për Menaxhimin dhe Mbrojtjen e Tokës lidhur me pasqyrat financiare në formatin nr. 1, llogaria 214 “*Instalime teknike, pajisje, instrumente*”, si harta, rafte, stenda, komodina, etj., të përfshihen të grupuar në grupe artikujsh në llogaritë sintetike sipas emërtesës dhe funksionit.

***Menjëherë***

4. Këshilli i Qarkut Elbasan, Drejtoria Ekonomike në llogarinë 212 “*Ndërtime Konstruksione*” të sistemohet pasqyrimi i shumës prej **4,087,796 lekë** e përdorur për rikonstruksionin e ndërtesës së Qarkut, pasi kjo shumë nuk mund të bëhet objekt i inventarit për aq kohë sa nuk është zgjidhur pronësia e objektit në të cilën ushtrojnë detyrën si Prefektura ashtu dhe Këshilli i Qarkut.

***Menjëherë***

5. Këshilli i Qarkut Elbasan, Drejtoria Ekonomike të pasqyrojë me të dhëna të plota në llogarinë 218 “*Inventar Ekonomik*” të gjitha pajisjet elektronike ku të evidentohen të dhëna si numri i serisë, viti i blerjes apo vënies në shfrytëzim etj.

***Menjëherë***

6. Këshilli i Qarkut Elbasan, Drejtoria Ekonomike për Degët e Thesarit Elbasan, Peqin, Librazhd dhe Gramsh, të bllokojnë përdorimin e transfertës së pakushtëzuar, në rast se njësitë e qeverisjes vendore nuk zbatojnë vendimin e KQ për derdhjen e detyrimeve që kanë njësitë vendore të këtij qarku, pasi në bazë të udhëzimit nr. 3, datë 17.01.2014 “*Për zbatimin e buxhetit të vitit 2014*”, pika 47, “*Te ardhurat e qarqeve nga kuota e njësive vendore*”, strukturat përgjegjëse për thesarin në degë, me autorizim të Këshillit të Qarkut, bllokojnë

përdorimin e transfertës së pakushtëzuar, në rast se njësitë e qeverisjes vendore nuk zbatojnë vendimin e Këshillit të Qarkut përkatës.

*Afati i zbatimit deri ne 31.12.2014*

7. Drejtoria Ekonomike krahas faturave të vitit 2014, të presë dhe faturat për detyrimet e viteve 2012-2013 për vlerën **17,641,341 lekë**, që kanë njësitë vendore të varësisë. Këshilli i Qarkut Elbasan të kërkojë arkëtimin e tyre nga njësitë vendore.

*Afati i zbatimit deri ne 31.12.2014*

8. Sekretari i Këshillit të Qarkut Elbasan të paraqesë çdo muaj pranë Drejtorisë së Financë Buxhetit listë prezencën e anëtarëve të Këshillit të Qarkut për pagesat e këshilltarëve.

*Në vazhdimësi*

9. Të përputhen emërtimet e nëpunësve sipas funksionit të përcaktuar në rregulloren e Këshillit të Qarkut me atë të listës së nëpunësit të administratës, pasi në Rregullore emërtimi është: Drejtoria e Koordinimit dhe e Zbatimit të Strategjive Rajonale ndërsa në listën e nëpunësve: Drejtoria e Përgjithshme e Koordinimit dhe Hartimit të Politikave.

*Menjëherë*

10. Marrja dhe dorëzimi i detyrës duhet të kryhet pasi procedurave standarde duke hartuar një procesverbal mbi dorëzimin e detyrës dhe dokumentacionit. E njëjta procedurë të kryhet për punonjësit e rekrutuar rishtazi në institucion.

*Vazhdimisht*

11. Këshilli i Qarkut Elbasan të miratojë rregulla specifike të procedurave për ruajtjen, mbrojtjen e nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të njësisë publike, bazuar në Manualin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit dhe të përcaktohen rregulla për administrimin dhe ruajtjen e aktiveve të qëndrueshme.

*Menjëherë*

12. Të hartohet Rregullore e Brendshme e Këshillit të Qarkut, duke përshkruar detyrimet dhe të drejtat për secilin pozicion pune, konfliktin e interesit, linjat e raportimit, etj, në funksion të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2011.

*Në mbledhjen më të afërme të Këshillit Qarkut*

13. Këshilli i Qarkut Elbasan të marrë masa për planifikimin në mënyrë analitike të shpenzimeve operative sipas strukturës buxhetore në nivel artikulli. Mallrat që përfshihen në një grup për shkak të funksionit kryesor që nevojiten të planifikohen në regjistrin e parashikimeve të prokurimeve publike si një zë i vetëm.

*Menjëherë*

14. Në funksion të përmbushjes së detyrimit institucional mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin, titullari i njësisë publike (KQ), të hartojë politikat dhe strategjinë e menaxhimit të riskut dhe të plan-veprimeve për arritjen e objektivave.

*Vazhdimisht*

15. Këshilli i Qarkut Elbasan, të ngrejë grup pune të përbërë nga specialistë të institucionit dhe të njësisë vendore, me qëllim evidentimin e treguesve fizikë e kimikë të fondit të tokës dhe zonat e dëmtuara ose të rrezikuara nga dëmtimet fizike, erozioni, shkretëtirëzimi, degradimi dhe ndotja.

*Menjëherë*

16. Këshilli i Qarkut Elbasan të ngrejë grupet e punës si grupi për menaxhim, strategji, buxhet dhe integrim (GMSBI) dhe ekipet e menaxhimit të programeve (EMP) , të përbëra

nga specialistët e institucionit dhe të njëjsteve vendore, të juridiksionit të Qarkut, me synim evidentimin e projekteve për shfrytëzimin e resurseve dhe marrjen e masave konkrete.

**Menjëherë**

**17.** Këshilli i Qarkut Elbasan të rekrutojë vetëm specialistë me arsim të lartë, si dhe të promovojë rritjen e nivelit arsimor e profesional të stafit. Për specialistë të cilët janë në marrëdhënie pune por që kualifikimi arsimor nuk është në përputhje me vendin e punës, të kërkohet kualifikimi i mëtejshëm arsimor e profesional.

**Vazhdimisht**

## **B. MASA DISIPLINORE**

Mbështetur në Kreu IV, germa “c” dhe “ç” dhe neni 144 dhe 37, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr. 8085, datë 13.03.1996 dhe ligjin nr. 9125, datë 29.07.2003, si dhe në kontratën individuale të punës, **kërkojmë** që Kryetari i Këshilli Qarkut Elbasan bazuar në nenin 44 të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore, si më poshtë:

### **“Vërejtje me paralajmërim” për:**

1. **K.H.** me detyrë Kryeinspektor i INU-së

2. **V.K.** me detyrë specialist për asistencë ligjore në INU

Për mos zbatimin e rekomandimeve të KLSH dhe mos ndjekjen e procedurave ligjore për arkëtimin e detyrimeve, duke mos vepruar në pajtueshmëri me nenin 16 të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve”, nenin 1, të ligjit nr. 10078, datë 16.2.2009, “Për urbanistikën”, si dhe nenin 30 të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për Kundërvajtjet Administrative”.

3. **F.K.** me detyrë Drejtore e Drejtorisë Financë-Buxhetit dhe

4. **O.A.** me detyrë Drejtore e Drejtorisë Shërbimeve Rajonale

Për mos ndjekjen e procedurave për ndërhyrjen në rrugë ligjore për arkëtimin e gjithë debitorëve në të gjitha shkallët e gjykimit si dhe mos pasqyrimin me evidenca të sakta në bilanc dhe në inventar të rrugëve, ndërmarrjeve vartëse të cilat janë në pronësi të Këshillit të Qarkut Elbasan, duke mos vepruar në pajtueshmëri me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, VKM nr. 783 datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël” të ndryshuar, si dhe UMF nr. 26, dt. 27.12.2007 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të institucioneve qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësitë që varen prej tyre si dhe njëjsteve të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorët e huaj.”

5. **K.P.** me detyrë Drejtor i Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës

Për mos evidentim të treguesve fizikë e kimikë të fondit të tokës dhe zonat e dëmtuara ose të rrezikuara nga dëmtimet fizike, erozioni, shkretëtirëzimi, degradimi dhe ndotja; - Për mosbashkëpunim me ZMT në komunat e qarkut, për përcaktimin e dëmtimeve të tokës bujqësore nga ndërtimet pa leje, si dhe nuk ishte marrë asnjë masë administrative për këtë qëllim; -Për mos kryerje të kontrollove mbi zbatimin e projekteve për shfrytëzimin e resurseve nga shoqëritë private, si dhe nuk ishte marrë asnjë masë administrative duke mos vepruar në pajtueshmëri me pikat 3, 24 dhe 25 të VKM nr. 532, datë 31.10.2002 “Për

*mënyrat e ushtrimit të funksioneve nga Seksionet e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës në qark dhe Zyrat e Menaxhimit dhe Mbrojtjes së tokës në Komunë ose Bashki”, i ndryshuar.*

**Shënim:**

Për punonjësit:

1. **D.LI.** me detyrë ish specialiste në Sektorin Urbanistikës e larguar më datë 21.12.2012, në pension pleqërie;
2. **E.M.** me detyrë ish specialist në Sektorin Urbanistikës larguar nga puna më datë 14.11.2011, nuk rekomandojmë masa disiplinore, sepse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë, nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personat nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien, ndjekjen e zbatimit të tyre. Masa e propozuar do të ishte **“Largim nga detyra”**.

Nga Këshilli i Qarkut Elbasan me shkresë e protokolluar në KLSH me nr. 459/9 datë 09.9.2014, është kthyer përgjigje së bashku me planin e masave për zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga KLSH, **pra rezulton se rekomandimet janë pranuar dhe zbatuar pjesërisht.**

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, Kontrollit të Territorit dhe Administrimit të Aseteve të Qëndrueshme.

*Shënim:* Auditimi është kryer nga audituesit Rezart Golemaj, Mirland Cela, Julian Adili dhe Vasil Vane më tej u shqyrtua nga z. Selfo Zeneli kryeauditues, z. Bajram Lamaj Drejtor i Departamentit, z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike, dhe Zbatimit të Standardeve, si dhe u verifikua si praktikë nga znj. Luljeta Nano, Sekretar i Përgjithshëm.